UDHËZIM
Nr. 14, datë 2.11.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 3.2.2022, "PËR PROGRAMIN, TRAJNIMIN, TESTIMIN DHE LËSHIMIN E CERTIFIKATËS PËR KËSHILLTARËT E SIGURISË NË TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME DHE TARIFAT PËRKATËSE"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të neneve 28, 29, 30, 31, të ligjit nr. 118/2012, datë 13.12.2012, "Për transportin e mallrave të rrezikshme", dhe neneve 115/1, 119, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 68, të ligjit nr. 142, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë",

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 5, datë 3.2.2022, "Për programin, trajnimin, testimin dhe lëshimin e certifikatës për këshilltarët e sigurisë, në transportin e mallrave të rrezikshme dhe tarifat përkatëse", bëhen këto ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

1. Në nenin 9, pas pikës 2.6, shtohen pikat 2.7, 2.8 dhe 2.9, me përmbajtjen si më poshtë:

"2.7 Mungesa e pjesëmarrjes në trajnim përbën shkak për moslejimin e kryerjes së testimit. Për këtë qëllim, evidentimi i pjesëmarrjes kryhet me nënshkrimin nga kandidati të fletëve të regjistrimit ose në mënyrë elektronike.

2.8 Kandidatët që do të pajisen me Certifikatën e Këshilltarit të Sigurisë duhet të jenë me profesion inxhinierë mekanikë, inxhinierë kimistë dhe/ose inxhinierë nafte dhe gazi.

2.9 Numri minimal i kandidatëve për fillimin e kurseve të trajnimit të jetë 10 persona. Në raste të veçanta, ky numër mund të ndryshojë, në varësi të kërkesave të të interesuarve dhe të infrastrukturës së trajnimit (ambientet e trajnimit, trupa e trajnimit, etj.).".

Neni 2

1. Në nenin 12, pika 5, riformulohet, si më poshtë:

"5. Komisioni i testimit përgatit detyrat me shkrim për testimin, informon kandidatët për këshilltarë sigurie mbi procedurën e zhvillimit të testimit, zhvillon testimin dhe pas shqyrtimit të rezultateve të tij, ua komunikon kandidatëve, si dhe plotëson dokumentacionin përkatës".

Neni 3

1. Në aneksin II, (organizimi i testimit), pas pikës 9, shtohet pika 10, me përmbajtjen si më poshtë:

"10. Për rinovimin e certifikatës së trajnimit, kandidatët do të marrin një pyetësor, i cili përfshin 20 pyetje të hapura, që mbulojnë minimalisht çështjet e cituara në këtë aneks (përkatësisht kapitujt 1.8.11 të ADR-së). Si dhe bazuar në programin përkatës të trajnimit të përcaktuar në këtë udhëzim".

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR DHE MINISTËR
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Belinda Balluku